



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka u Srbiji
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka u Srbiji Chamber of nurses, midwives and other health professionals		
Nr. Prot. 428	Nr. i faq. 1	Arkiv
Prot. no	No. page	ARKIV ARHIV ARCHIVE
		Prishtinë
		Date: 01.06.2021

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues të datës: 31.05.2021 OIK shpallë:

FTESË PUBLIKE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË OIK-ut

Ftojme kompanitë audituese të licencuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), që të paraqesin ofertat e tyre për: **Auditimin e pasqyrave financiare të Odës së Infermierëve të Kosovës për vitin 2019 dhe 2020.**

Objektivat dhe fushëveprimi i punës:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që të mundësojë auditorin të shprehë një opinion profesional, mbi pozicionin financiar dhe të ardhurave e shpenzimeve për periudhën kontabël. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë, të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyshme në lidhje me pasqyrat financiare. Auditimi përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Kjo gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ofertat e paraqitura duhet të përmbajnë:

- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur;
- Përvojat në auditimin e institucioneve të tjera të ngjashme me OIK;
- CV- të dhe referencat për stafin dhe përvojat e tyre; dhe
- Ofertën financiare.

Përzgjedhja e auditorit të pavarur bëhet nga Komisioni për Auditim i OIK-ut, pas mbylljes së afatit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet pranë zyrave të OIK-ut në formë fizike, ditëve të punës, nga ora 09:00 deri në ora 14:00.

Afati i aplikimit është 5 ditë pune, nga data: 04.06.2021 deri me datë: 10.06.2021

Data e publikimit:
04.06.2021



Kryetari i Komisionit
Ismet Jashari